



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR

MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL
NË INSTITUCIONIN KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)

Tiranë, Maj 2024

**RAPO
RT
(Përfundimtar)**

**Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).**

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të punës së Komisionerit të miratuar me vendimin nr. 106, datë 15.12.2023, të Komisionerit *“Për miratimin e planit vjetor të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2024”*, si dhe të urdhrin nr. 20 (103 prot.), datë 30.1.2024 *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i krijuar me ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar (me ligjet nr. 74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, nr. 118/2020, datë 5.10.2020; shfuqizuar një pikë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 30.6.2021, shfuqizuar një fjali me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 4.10.2021).

Organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e KQZ-së, organeve drejtuese dhe administratës, bëhen në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe rregulloren *“Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”*, të miratuar me vendimin nr. 21, datë 26.2.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (ky vendim ka shfuqizuar rregulloren e vjetër të miratuar me urdhrin nr. 181, datë 06.04.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve).

Organet drejtuese të KQZ-së janë:

- a) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët.

- b) Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organ që funksionon me kohë të pjesshme (vetëm në periudha zgjedhore) dhe miraton akte normative në fushën e zgjedhjeve.
- c) Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) është organ që funksionon me kohë të pjesshme (vetëm në periudha zgjedhore). Ai shqyrton ankimet administrative dhe vendos sanksione për shkeljet e ligjit zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, i shfuqizuar, dhe ky status është ruajtur edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, i cili ka përfshirë në fushën e veprimit të tij, ndër të tjera, edhe institucionet e pavarura, parashikuar në nenin 2, të ligjit, ku përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Më tej, në pikën 1/b, të nenit 4, të ligjit, jepet përkufizimi i termit “*Institucion i pavarur*”, ku përcaktohet se “*Institucion i pavarur*” është *administrata e Kuvendit, e Presidentit, e pushtetit vendor, e Gjykatës Kushtetuese, ... dhe çdo institucion i pavarur, i parashikuar në Kushtetutë apo i krijuar me ligj dhe që i raporton Kuvendit, përfshirë degët e tyre territoriale*”. Referuar përcaktimeve të pikës 1/ll, të nenit 19, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është institucion kushtetues që i raporton Kuvendit për veprimtarinë e institucionit.

Dispozitat ligjore si më sipër, e përfshijnë institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, duke e bërë atë subjekt të kësaj mbikëqyrjeje.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institucionet e ligjit për nëpunësin civil, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Zamira Mujali dhe Behare Hoxha, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Ky material, me shkresën nr. 103/3 prot., datë 22.4.2024, u dërgua për njohje pranë institucionit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet e tyre në lidhje me gjetjet e grupit të punës.

Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 103/4 prot., datë 02.5.2024, ka dërguar të nënshkruar projektraportin pa vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Qëllimi i mbikëqyrjes:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para njësisë përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil dhe titullarit të institucionit, konstatimet dhe faktet e evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi dhe shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

DREJTIMET E MBIKËQYRJES:

Mbikëqyrja është orientuar drejt verifikimit të situatës së administrimit të shërbimit civil në këtë institucion, për të arritur në konkluzion se si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me respektimin e skemës së administrimit të shërbimit civil si dhe të procedurave që ndiqen gjatë aplikimit të instituteve të ligjit. Disa nga drejtimet në të cilat është orientuar mbikëqyrja janë:

1. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
2. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
3. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.

4. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22 dhe akteve nënligjore në lidhje me dy fazat e këtij procesi:
 - verifikimi paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse konkurrentët i plotësojnë kërkesat e përgjithëshme dhe të veçanta të vendit të punës;
 - vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit.
5. Emërimet në shërbimin civil pas përfundimit të procesit të konkurrimit dhe menaxhimi i listës së kandidatëve fitues që kanë arritur pikët, por që nuk janë emëruar. Evidentimi i rasteve të emërimit pa konkurrim, në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit për nëpunësin civil.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*si janë zbatuar detyrimet e nëpunësit dhe eprorit si dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
7. Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive dhe respektimi i kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 25 të ligjit për nëpunësin civil, gjatë zhvillimit të kësaj procedure nga Komisioni i Brendshëm.
8. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26 i ligjit për nëpunësin civil, nga njësia përgjegjëse dhe Komiteti i Pranimit gjatë zhvillimit të dy fazave të konkurrimit:
 - verifikimit paraprak;
 - vlerësimi i kandidatëve.
9. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32 të ligjit për nëpunësin civil nga ana e titullarit të institucionit (*respektimi i kufirit prej 15% të pranimet nga jashtë shërbimit civil*); respektimi i kërkesave ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse për organizimin e konkurrimit dhe respektimi i procedurave të konkurrimit nga ana e Komisionit të Përhershëm të Pranimit, gjatë realizimit të procesit.
10. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).

11. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj, duke verifikuar se si janë zbatuar kërkesat ligjore për procedurat që janë zhvilluar në këto raste.
12. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, duke filluar nga kërkesa për nisjen e ecurisë disiplinore, deri në marrjen e vendimit përfundimtar, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 115, datë 05.3.2014.
13. Vlerësimi i rezultateve në punë, si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues, zyrtar autorizues*).
14. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
15. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore/njësisë përgjegjëse, gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Aktet administrative që janë vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes janë:

1. Struktura organizative dhe analitike e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që nga viti 2019 e në vijim.
2. Listëprezenca dhe listëpagesa e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për muajin **Janar 2024**.
3. Formulari i përshkrimit të punës për çdo pozicion që është pjesë e shërbimit civil.
4. Materialet që dokumentojnë procesin e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
 - Plani vjetor i rekrutimit ku të jetë përfshirë edhe nevoja për rekrutim nga jashtë shërbimit civil për pozicionet e ulta dhe të mesme drejtuese (20%) dhe të lartë drejtuese (15%).
 - Shpallja e vendit të lirë (*grup pozicionesh –nivël ekzekutiv/pozicion për ngritje në detyrë -nivël i lartë drejtues/nivël i ulët ose i mesëm drejtues*).
 - Kërkesa dërguar AKPA/shpallja në faqen e internetit të institucionit.
 - Aktet që vërtetojnë respektimin e afateve në shpallje (*sipas aktit nënligjor dhe udhëzimit të DAP*).
 - Aktet që materializojnë përbërjen e Komisionit të Përhershëm të Pranimit - për nivelin ekzekutiv.

- Aktet që materializojnë procedurat e ndjekura për fazën e verifikimit paraprak:
 - Lëvizje paralele nivel ekzekutiv (*dërgimi për publikim në AKPA*);
 - Lëvizje paralele në nivelin e mesëm dhe të ulët (*dërgimi për publikim në AKPA*);
 - Lista e kandidatëve të skualifikuar – arsyet dhe komunikimi me ta;
 - Ankimimi;
- Aktet që materializojnë procesin e pranimit në shërbimin civil:
 - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar mbas ankimimit (*nëse ka dhe dërgimi për publikim*) në nivel ekzekutiv;
 - procesverbli i prezencës në testimin me shkrim;
 - hartimi i tezës nga KPP /sekretimi;
 - procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
 - verifikimi i përgjigjeve të dhëna nga kandidatët e kualifikuar për testimin me shkrim; pyetjet e përzgjedhura nga KPP për këtë fazë;
 - pyetjet e intervistes me gojë;
 - deklarata e rregjistrimit audio;
 - deklarata e paanësisë së KPP;
 - raporti i KPP për rezultatet (*para ankesave*);
 - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues;
 - shpallja e fituesit në AKPA;
 - deklarata e pranimit të pozicionit – rregjistrimi në listën e fituesve të atyre që nuk pranojnë pozicionin;
 - procedura e ankimimit nëse ka;
- Aktet që materializojnë procesin e ngritjes në detyrë:
 - akti që materializon ngritjen e Komitetit të Pranimit;
 - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar mbas ankimimit (*nëse ka dhe dërgimi për publikim*);
 - procesverbali i prezencës në testimin me shkrim;
 - hartimi i tezës nga KPND /sekretimi;
 - procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
 - pyetjet e intervistës me gojë;
 - deklarata e rregjistrimit audio;
 - deklarata e paanësisë së KPND;
 - raporti i KPND;
 - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues;
 - shpallja e fituesit në AKPA;

- akti që materializon vendimin për pranimin në shërbimin civil sipas nenit 26/4 (për 20%) dhe për pranim në shërbimin civil, në nivelin e lartë drejtues (për 15 %);
- verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar pas ankimit (nëse ka dhe dërgimi për publikim);
- procesverbali i prezencës në testimin me shkrim;
- hartimi i tezës nga KPND /sekretimi;
- verifikimi i përgjigjeve të dhëna nga kandidatët e kualifikuar për testimin me shkrim sipas pyetjeve të përzgjedhura nga KPP për këtë fazë;
- procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
- pyetjet e intervistës me gojë;
- deklarata e rregjistrimit audio;
- deklarata e paanësisë së KPND;
- raporti i KPND;
- vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues
- shpallja e fituesit në AKPA;
- akti i emërimit të punonjësve në pozicionin e shërbimit civil

5. Formulari i vlerësimit të punës.

6. Dosjet e personelit dhe regjistri i personelit.

7. Materiale të tjera që janë konsideruar të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të mbikëqyrjes.

Metodologjia e mbikëqyrjes:

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e institucionit, si dhe në drejtorinë e burimeve njerëzore, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- U verifikuan pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës e cila është në fuqi në momentin e mbikëqyrjes në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

- U verifikuan të gjitha materialet që dokumentojnë procesin e pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, mbi bazën e planit vjetor të rekrutimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- U verifikua nëse institucioni kishte hartuar përshkrimet e punës, sipas rregullave të parashikuara nga legjislati i shërbimit civil.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës, të çdo nëpunësi, për të provuar përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës, si arsimi, përvoja në punë e të tjera.

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete (tabela nr. 1 dhe nr. 2), si dhe në procesverbalet/aktkonstatimet, të cilat janë pjesë e këtij projektraporti.

Përmbajtja e Raportit:

- I. **Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me respektimin e skemës së administrimit të shërbimit civil.**

Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në momentin e mbikëqyrjes, institucioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar me vendimin nr. 67/2020, datë 5.11.2020, të Kuvendit “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, i ndryshuar me vendimet e Kuvendit nr. 74/2022, datë 22.9.2022 dhe nr. 114/2023, datë 2.11.2023.

Miratimi i vendimit nr. 74/2022, të Kuvendit, ka sjellë ndryshime që kanë të bëjnë me riorganizimin e vendeve të punës, nëpërmjet shkrirjes apo krijimit të njësive të reja organizative, rishpërndarjes së burimeve njerëzore për kryerjen e funksioneve, si dhe shtimit të vendeve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat janë arsye për zhvillimin e procesit të ristrukturimit. Në këtë moment, ripozicionimi i të gjithë punonjësve në strukturën e re është bërë në zbatim të procedurave të ristrukturimit të institucionit të parashikuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe pikat nga 13 deri në 23 të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Në bazë të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreut II “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, i

cili ka dalë në mbështetje të nenit 50, të ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, i ndryshuar, rezulton se, institucioni kalon në proces ristrukturimi, sa herë që konstatohet plotësimi i kërkesave ligjore për të pasur një proces të tillë:

- a) shtohen vendet e punës pjesë e shërbimit civil;
- b) ristrukturohen vendet e punës ekzistuese;
- c) për kryerjen e funksioneve të institucionit bëhet e nevojshme një rishpërndarje e burimeve njerëzore.

Në këtë rast, njësia e burimeve njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, drejton gjithë procesin e ristrukturimit nga ana ligjore, që nga krijimi i Komisionit të Ristrukturimit dhe më tej, pas propozimit të bërë prej këtij mekanizmi, ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për sistemimin e çdo nëpunësi civil në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit.

Nga krahasimi i strukturave, asaj pararendëse dhe strukturës aktuale, konstatohet se në rastin konkret, ristrukturimi ka sjellë shtim të vendeve të punës (nga 65 pozicione pjesë e shërbimit civil, në 75 të tilla), si dhe janë riorganizuar pozicione aktuale, ç’ka do të thotë, që për nëpunësit të cilët preken nga ky ristrukturim, duhet të ndiqet e gjithë procedura e hollësishme që parashikohet në Kreun II “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të VKM nr. 125, datë 17.2.2016 dhe në udhëzimin e DAP.

Në këtë rast, në zbatim të pikës 15, të aktit nënligjor, nëpërmjet aktit nr. 62 prot., datë 06.1.2023, të njësisë përgjegjëse, janë njoftuar nëpunësit për fillimin e procedurës së ristrukturimit për shkak të këtij riorganizimi.

Më pas, me Urdhrin nr.2, datë 09.1.2023, të titullarit të institucionit, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, i cili përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e kryetarit, një përfaqësues i njësisë së burimeve njerëzore dhe njëkohësisht Drejtor i Burimeve Njerëzore, si dhe një specialist i Burimeve Njerëzore, që të dy, me cilësinë e anëtarit. Numri i anëtarëve të komisionit është në përputhje me përcaktimet e pikës 17, të kreut II, të VKM nr. 125, datë 17.2.2016, ku parashikohet se “Komisioni përbëhet nga tre anëtarë dhe krijohet nga njësia përgjegjëse sipas rastit”.

Komisioni i Ristrukturimit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pozicioneve të punës, në zbatim të kompetencave të parashikuara në pikën 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe në pikën 17/a, Kreu II, të aktit nënligjor, si dhe pasi vlerësoi përputhshmërinë e kritereve të veçanta të pozicioneve të lira me të dhënat e nëpunësve të prekur nga ristrukturimi, me vendimin nr. 199 prot., datë 17.1.2023, ka propozuar transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë në pozicione, të cilat janë riorganizuar për shkak të ristrukturimit.

Në vijim, njësia përgjegjëse e institucionit, pasi ka marrë në shqyrtim propozimet e bëra nga Komisioni i Ristrukturimit, me aktin nr. 234 prot., datë 18.1.2023, ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë, vendet e të cilëve kanë pësuar ndryshime për shkak të restrukturimit, për të gjitha rastet e propozuara. Pasi ka njoftuar nëpunësit për këtë vendim, ka marrë edhe mendimin e tyre me shkrim, në zbatim të pikës 20, të kreut II, të aktit nënligjor, nga ku nuk rezulton asnjë rast refuzimi në lidhje me vendimin e transferimit si rezultat i restrukturimit.

I gjithë procesi i restrukturimit *është shoqëruar me aktet e emërimit* për çdo punonjës, sipas pozicionit të punës ku është transferuar për shkak të restrukturimit, si dhe me hartimin e përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet që restrukturohen.

Konstatim: Nga sa analizuam në këtë rubrikë të raportit, konstatohet se procesi i restrukturimit është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij.

Më tej, me vendimin nr. 114/2023, të Kuvendit, është bërë implementimi i rregullimeve të reja lidhur me strukturën dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë, pa e ndryshuar organizimin e njësie organizative, numrin e përgjithshëm të punonjësve, si dhe të pozicioneve të shërbimit civil.

Nga analiza e strukturës dhe organikës që është në fuqi në momentin e mbikëqyrjes, rezulton se, institucioni i mbikëqyrrur ka gjithsej **95** pozicione pune të miratuara. Ndarja e pozicioneve të punës, bazuar në funksionet që ato kryejnë paraqitet si më poshtë:

- Për **20** pozicione pune, nuk zbatohet ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi janë funksione politike dhe administrative, ku përfshihen:
 - **2** pozicione pune, funksionarë të emëruar nga Kuvendi (*Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve*).
 - **4** pozicione pune, funksionarë kabinetit, (*drejtor kabinetit + 2 këshilltarë + 1 zëdhënës*).
 - **14** pozicione pune, punonjës administrativë, (*4 sekretare + 1 receptionist + 1 teknik fotokopjues + 1 magazinier + 1 postier + 2 shoferë + 1 punëtor mirëmbajtës + 3 punonjës pastrimi*).
- **75 pozicione pune, janë pjesë e shërbimit civil.**

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, nisur nga emërtesa e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, ato paraqiten në këtë raport :

- 3 pozicione të kategorisë së lartë drejtuese, ose rreth **4 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, që i përkasin pozicioneve “Sekretar i Përgjithshëm”, kategoria e pagës I-2; “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Zgjedhjeve”, kategoria e pagës I-4; “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse”, kategoria e pagës I-4.
- 8 pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, ose rreth **11 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, që i përkasin pozicioneve “drejtor drejtorie”, kategoria e pagës II-1.
- 16 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese, ose rreth **21 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, i përkasin pozicionit “shef sektori”, kategoria e pagës III-1.
- 45 pozicione të kategorisë ekzekutive, ose **64 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, i përkasin pozicionit “specialist”, kategoria e pagës IV-1.

Bazuar në strukturën dhe organikën që është në fuqi në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, institucioni Komisioni Qendor i Zgjedhjeve, ka **75** pozicione të shërbimit civil, ku në momentin e kryerjes së verifikimit në institucion rezulton se, **67** pozicione pune janë të plotësuara dhe **8** pozicione janë vende të lira.

Evidentojmë faktin se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 1, shkronja “f”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, paraqitet si njësi përgjegjëse në administrimin e shërbimit civil të institucionit të pavarur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Konstatim:

- Në përmbajtjen e strukturës organizative të institucionit të mbikëqyrur, evidentohen në mënyrë të qartë, pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, si dhe pozicionet e punës ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil, siç janë: funksionarët e emëruar nga Kuvendi, funksionarët e kabinetit dhe punonjësit administrativë.
- Numri i punonjësve për çdo njësi organizative, është brenda standardeve të miratuara me ligjin për administratën shtetërore, i cili përdoret për analogji në këtë rast.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, në vijim, në përmbajtjen e këtij raporti do të analizohen në mënyrë të detajuar procedurat për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, të realizuara përgjatë periudhës objekt mbikëqyrje.

II. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, u verifikuan përshkrimet e punës, për të vlerësuar nëse janë respektuar rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, si akt nënligjor që ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ky akt nënligjor, në përmbajtjen e tij ka të përcaktuara rastet kur një institucion, pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojë përshkrimet e punës, procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen si dhe nëpunësit përgjegjës në këtë proces.

Nga verifikimet e kryera, rezulton se pas miratimit të strukturës me Vendimin nr. 74/2022, të Kuvendit, institucioni i mbikëqyrur, ka hyrë në një proces ristrukturimi.

Për këtë arsye, në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në pikën 14, të Kreut IV “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës”, si dhe të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ku përcaktohet se: “Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”, janë hartuar përshkrimet e reja të punës, duke pasqyruar ndryshimet e ndodhura.

Nga përmbajtja e përshkrimeve të punës të verifikuara në subjekt, konstatohet se në këto akte, **janë përfshirë** elementet sipas modelit standard të miratuar, si dhe të dhënat për pozicionin e punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës, si dhe është nënshkruar nga aktorët përgjegjës.

Gjithashtu, konstatohet se në ndarjen “Kërkesa të posaçme”, **janë përcaktuar kërkesat e posaçme** që duhet të plotësojë nëpunësi për nivelin e arsimit (niveli i diplomës “Bachelor”, “Master Profesional”, “Master i Shkencave” që kërkon pozicioni i punës); profili i arsimit të lartë; përvoja në punë e përcaktuar në terma kohorë; kualifikimet/trajnimet dhe kërkesa të tjera të posaçme sipas pozicionit të punës. Përshkrimet e punës, **janë të nënshkruara** dhe ruhen në dosjen e personelit.

Konstatim: Nga sa analizuam më sipër, arrijmë në përfundimin se, procedura e ndjekur për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës në pozicionet pjesë e shërbimit civil nga ana e njësisë përgjegjëse në institucionin e mbikëqyrur, **është në përputhje** me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil dhe të Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

III. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

III/1. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.

Administrimi i shërbimit civil për të gjithë institucionet e administratës shtetërore bazohet në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, detyrë kjo e parashikuar në nenin 18, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Më tej, në mbështetje të kësaj dispozite është miratuar vendimi nr. 108, datë 26.2.2014, i Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, në të cilin janë përcaktuar procedurat e hollësishme për përgatitjen, miratimin, afatin e miratimit dhe mënyrën e bërjes publike të planeve vjetore të punësimit.

Në pikën 4 dhe 13 të këtij akti nënligjor përcaktohet se, çdo institucion i administratës shtetërore, përgatit planin e nevojave të tij për rekrutim në shërbimin civil, për vitin e ardhshëm. Institucionet e pavarura publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në protalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftimet publike të institucionit.

Në respektim të afatit të vendosur në pikën 11, të VKM-së nr. 108, datë 26.2.2014, planet vjetore të pranimit në shërbimin civil duhet të miratohen në fillim të çdo viti kalendarik (*gjatë periudhës janar- shkurt*).

Nga dokumentacioni i këqyrur për periudhën objekt mbikëqyrjeje, në lidhje me miratimin e këtij plani, rezulton se subjekti i mbikëqyrur ***e ka përgatitur planin vjetor*** të rekrutimit në shërbimin civil, për secilën periudhë të verifikimit (*viti 2019, 2020, 2021, 2022, 2023*), ***brenda afatit*** të parashikuar në dispozitat si më sipër (*brenda muajit shkurt të çdo viti*), siç është parashikuar në pikën 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikën 11, të VKM nr. 108, datë 26.2.2014, ku përcaktohet se: “Njësitë e qeverisjes vendore dhe çdo institucion i pavarur, jo më vonë se muaji shkurt, miratojnë planet e veta të pranimeve vjetore. Planet vjetore të miratuara sipas kësaj pike publikohen”. Këto dispozita janë zbatuar si më poshtë:

➤ ***Plani i Pranimit në Shërbimin Civil, për vitin 2019***

Me aktin nr. 102, datë 23.1.2019 “Për miratimin e planit të pranimit në shërbimin civil”, është miratuar plani i rekrutimit për plotësimin e 4 pozicioneve të lira për vitin 2019 (1 pozicioni i nivelit të mesëm drejtues dhe 3 pozicione ekzekutive), të paraqitura si më poshtë:

- Pozicioni “Drejtor i Teknologjisë dhe Informacionit”, kategoria e pagës II-b.

- Pozicioni “*Specialist IT*”, Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit (III-b).
- Pozicioni “*Specialist redaktor*”, Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, kategori page III-b.
- Pozicioni “*Specialist prokurimesh*”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, kategori page III-b.

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil, viti 2020

Me aktin nr. 138, datë 03.02.2020 “Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil të KOZ, për vitin 2020”, është miratuar plani i rekrutimit për plotësimin e **2** pozicioneve të lira për vitin 2020, në kategorinë ekzekutive: pozicioni “*Specialist IT*”, Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit, dhe pozicioni “*Specialist jurist*”, Drejtoria e Juridike, me kategori page III-b.

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil, viti 2021.

Me aktin nr. 1045, datë 09.2.2021 “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”, është miratuar plani i rekrutimit për plotësimin e **15** pozicioneve të lira për vitin 2021 (*1 pozicion i nivelit të lartë drejtues, 5 pozicione të nivelit të ulët drejtues dhe 9 pozicione ekzekutive*), të paraqitura si më poshtë:

- Pozicioni “*Drejtor i Përgjithshëm i Administrimit Zgjedhor*”, kategoria e pagës II-a.
- Pozicioni “*Shef i Sektorit të Koordinimit dhe Mbikëqyrjes*”, Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore, kategoria e pagës III-a.
- Pozicioni “*Specialist i materialeve zgjedhore*”, Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore, kategoria e pagës III-b.
- Pozicioni “*Shef i Sektorit të Administrimit të të Dhënave*”, Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve IT, kategoria e pagës III-a.
- Pozicioni “*Specialist Administrimit të të Dhënave*”, Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve IT, kategoria e pagës III-b.
- Pozicioni “*Shef Sekori për Votimin e Emigrantëve*”, Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve IT, kategoria e pagës III-a.
- Pozicioni “*Shef Sekori Programeve të Edukimit të Zgjedhësve*”, Drejtoria e Komunikimit, kategoria e pagës III-a.
- Pozicioni “*Specialist për përgatitjen e akteve*”, Drejtoria Juridike dhe dokumentacionit zgjedhor, kategoria e pagës III-b (**2 pozicione**).
- Pozicioni “*Specialist për verifikimin e dokumenteve dhe ankesat administrative*”, Drejtoria Juridike dhe dokumentacionit zgjedhor, kategoria e pagës III-b.
- Pozicioni “*Specialist auditi*”, Sektori Auditit të Brendshëm, kategoria e pagës III-b
- Pozicioni “*Shef Sekori i Kontrollit Financiar*”, Drejtoria e Kontrollit Financiar, kategoria e pagës III-a.
- Pozicioni “*Specialist për kontrollin financiar*”, Drejtoria e Kontrollit Financiar, kategoria e pagës III-b
- Pozicioni “*Specialist finance*”, Drejtoria e Kontrollit Financiar, kategoria e pagës III-b

- Pozicioni “*Specialist i burimeve njerëzore*”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, kategoria e pagës III-b

➤ *Plani i Pranimit në Shërbimin Civil, viti 2022*

Me aktin nr. 4 prot., datë 06.01.2022 “*Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil të KQZ për vitin 2022*”, është miratuar plani i rekrutimit për plotësimin e **9** pozicioneve të lira për vitin 2022 (4 pozicione shef sektori dhe 5 pozicione specialist), të paraqitura si më poshtë:

- Pozicioni “*Shef në Sektorin për votimin e emigrantëve*”, Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve IT, kategoria e pages III-a.
- Pozicioni “*Specialist në Sektorin për votimin e emigrantëve*”, Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve IT, kategoria e pages III-b.
- Pozicioni “*Shef në Sektorin e Programeve të Edukimit të Zgjedhësve*”, Drejtoria e Komunikimit, kategoria e pages III-a.
- Pozicioni “*Shef Sektori i Përgatitjes së Akteve*”, Drejtoria Juridike dhe Dokumentacionit Zgjedhor, kategoria e pagës III-a.
- Pozicioni “*Shef Sektori i Dekriminalizimit*”, Drejtoria Juridike dhe Dokumentacionit Zgjedhor, kategoria e pagës III-a
- **2** pozicione “*Specialist për verifikimin e dokumenteve mbi ankesat administrative dhe gjyqësore*”, Drejtoria Juridike dhe Dokumentacionit Zgjedhor, kategoria e pagës III-b.
- Pozicioni “*Specialist auditi*”, Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm, kategoria e pagës III-b.
- Pozicioni “*Specialist finance*”, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, kategori page III-b.

➤ *Plani i Pranimit në Shërbimin Civil, viti 2023.*

Për vitin 2023, me aktin nr. 407, datë 25.01.2023 “*Përcaktimi i planit vjetor të pranimit në shërbimin civil*”, është miratuar plani i rekrutimit për plotësimin e **14** pozicioneve të lira, të paraqitura si më poshtë:

- Pozicioni “*Specialist i dokumentacionit zgjedhor*”, Drejtoria e Administratës Zgjedhore, kategoria e pagës III-b.
- Pozicioni “*Shef sektori i zhvillimeve dixhitale*”, Drejtoria e Logjistikës dhe dhe Dixhitalizimit, kategoria e pagës III-a.
- Pozicioni “*Shef sektori i materialeve zgjedhore*”, Drejtoria e Logjistikës dhe dhe Dixhitalizimit, kategoria e pagës III-a.
- Pozicioni “*Shef sektori i administrimit të dhënave dixhitale*”, Drejtoria e Logjistikës dhe dhe Dixhitalizimit, kategoria e pagës III-a.
- Pozicioni “*Drejtor për Votimin nga Jashtë*”, kategoria e pagës II-b.

- 2 pozicione “*Specialist për zhvillimin e zgjedhjeve*”, Drejtoria për Votimin nga Jashtë, kategoria e pagës III-b.
- Pozicioni “*Shef sektori për ankimet dhe sanksionet*”, Drejtoria e Ligjshmërisë, kategoria e pagës III-a.
- Pozicioni “*Specialist për ankimet dhe sanksionet*”, Drejtoria e Ligjshmërisë, kategoria e pagës III-b.
- Pozicioni “*Specialist për informimin*”, Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, kategoria e pagës III-b.
- Pozicioni “*Specialist për koordinimin ndërkombëtar*”, Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, kategoria e pagës III-b.
- Pozicioni “*Specialist për buxhetin*”, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, kategoria e pagës III-b.
- Pozicioni “*Shef sektori i burimeve njerëzore*”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria e pagës III-a.
- Pozicioni “*Specialist auditit*”, kategoria e pages III-b.

Referuar pozicioneve vakante të evidentuara në planet e pranimit për vitin 2021, 2022 dhe 2023, të planifikuara për t’u plotësuar përmes procedurave të konkurrimit konstatohet se, në institucionin e mbikëqyrur janë zhvilluar gjithsej **56** procedura konkurrimi. Në dy raste procedurat kanë përfunduar pa fitues (“*Specialist IT*” për vitin 2019 – plotësuar me planin e vitit 2020 dhe “*Specialist auditit*” për vitin 2022 - plotësuar në planin e vitit 2023).

Gjithsej, me anë të konkurrimit janë plotësuar **45** pozicione pune (*27 emërimë në kategorinë ekzekutive, 15 emërimë në kategorinë e ulët drejtuese, 2 emërimë në kategorinë e mesme drejtuese dhe 1 emërim në kategorinë e lartë drejtuese me pranim nga jashtë shërbimit civil*) me nëpunës në strukturën aktuale të institucionit.

Në bazë të përcaktimeve të pikës 13, të VKM nr. 108, datë 26.2.2014, në të gjitha rastet, vendimi për miratimin e planit vjetor të punësimit, **është publikuar** në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*”, si dhe në faqen e internetit të institucionit.

Konstatim: Nga ana e institucionit të mbikëqyrur plani vjetor i pranimit në shërbimin civil **është hartuar dhe miratuar brenda afatit të përcaktuar**, duke marrë në konsideratë të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në parashikimet e nenit 18, të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”.

Gjithashtu, pozicionet e lira janë grupuar sipas kategorisë dhe kritereve të pozicioneve të punës dhe më pas procedurat e konkurrimeve **janë kryer në grup pozicionesh**. Disa procedura konkurrimi janë zhvilluar me më shumë se 1 kandidat pjesëmarrës, por në pjesën më të madhe,

pjesëmarrja në konkurrim ka qenë me një kandidat të vetëm, i cili në përfundim të procedurës së konkurrimit ka dalë fitues.

III/2. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv nëpërmjet konkurrimit të hapur dhe lëvizjes paralele.

III/2.a Plotësimi i pozicioneve të nivelit ekzekutiv nëpërmjet konkurrimit të hapur

Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, rregullohet nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (kreu IV “Pranimi në shërbimin civil”, nenet 20, 21, 22, 23 e 25); Vendimi nr. 243, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 2, datë 27.3.2015, i Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur” (kreu III “Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”).

Në pikën 2, të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në pikën 2, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, është përcaktuar se, konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga njësia përgjegjëse, si për grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe për grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm. Njësitë përgjegjëse në institucionet e vetëqeverisjes vendore organizojnë procedurën për institucionet respektive.

Në lidhje me plotësimin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të ngelura të lira pas aplikimit të lëvizjes paralele, u verifikua dokumentacioni i procedurave të konkurrimit për pranimin në kategorinë ekzekutive.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton që nga njësia përgjegjëse e institucionit të KQZ, për periudhën Janar 2019 - Dhjetor 2023, janë realizuar **26** procedura konkurrimi për pranim në shërbimin civil për 32 pozicione pune (në dy raste është bërë procedurë konkurrimi në grup).

Në të gjitha rastet, njësia përgjegjëse **ka publikuar shpalljen e procedurës** së pranimi në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, si dhe në Faqen Zyrtare të institucionit, e cila përmbante kriteret e përgjithshme dhe kërkesat specifike të pranimi në shërbimin civil (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit dhe shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim.

➤ Krijimi i Komitetit të Përhershëm të Pranimi (KPP) dhe vlerësimi i kandidatëve

Nisur nga përcaktimi i pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe rregullave të përcaktuara në Kreun III dhe IV (pikat nga 7 deri në 13), të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimi (KPP).

Krijimi i KPP, përbërja e tij, si dhe detyrat që duhet të kryejë ky organ, janë të parashikuara në Kreun III dhe IV të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe ndarjen III/3, III/4, III/5, III/6, III/7 e III/8, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimi të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Komiteti i Përhershëm i Pranimi, sipas pikës 3, Kreu III, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë:

- a) 1 anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson KPP-në;
- b) 2 anëtarë të zgjedhur nga titullari midis nëpunësve të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;
- c) 2 ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit për grupet përkatëse.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezulton që, **KPP ka në përbërjen e vet 5 anëtarë**, prej të cilëve: 3 përfaqësues të institucionit dhe 2 ekspertë të jashtëm të fushës së vlerësimit të pozicionit që zhvillohet procedura konkurruese.

Më tej, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit, dispozitat ligjore kanë përcaktuar që totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- Deri në 15 pikë, për vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve (CV) që konsiston në vlerësimin e arsimimit, përvojës e trajnimeve, të lidhura me fushën e njohurive, aftësive dhe cilësive të përfshira në shpalljen për konkurrim;
- Deri në 60 pikë, për vlerësimin me shkrim (një testim i shkruar);
- Deri në 25 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Në lidhje me vlerësimin e kandidatëve nga KPP-ja, nga verifikimi rezulton se, për vitet 2019 - 2023, **janë ndjekur rregullat** që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore, në lidhje me këtë fazë të konkurrimit.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se, për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPP, **kanë hartuar testet** përkatëse, të cilat, janë paraprirë nga procesverbali për përzgjedhjen e pyetjeve, i mbajtur nga anëtarët e KPP. Në të gjitha rastet **është hartuar** çelësi i përgjigjeve që duhet ta administrojë secili prej anëtarëve të KPP në momentin e zhvillimit të konkurrimit.

Testet përmbajnë pyetje me alternativa dhe me shtjellim sipas rregullave të përcaktuara në pikën 2, të ndarjes III/5, të udhëzimit të DAP, brenda fushës së njohurive dhe aftësive mbi të cilat do të zhvillohet testimi, të përfshira në shpalljen për konkurrim, por mungon bashkëlidhur përgjigja e saktë për secilën pyetje.

Anëtarët e KPP **kanë korigjuar** testet dhe **kanë vlerësuar** kandidatët duke dhënë pikët për secilin, duke zbatuar rregullat e pikës 8, të paragrafit III/6, të udhëzimit të DAP.

Në lidhje me intervistën me gojë, KPP: **ka hartuar** pyetjet që lidhen me njohuritë që nevojiten për pozicionin e punës dhe që janë brenda fushës së testimit; **ka respektuar** afatet e parashikuara për zhvillimin e intervistës së strukturuar me gojë dhe më pas **ka hartuar** procesverbalin për vlerësimin e konkurrentëve.

Në disa raste, kandidatët konkurrentë **nuk janë njoftuar** për nënshkrimin e deklaratës së pranimit ose mospranimit për të regjistruar intervistën me gojë.

Shpesh konstatohet se, **mungon deklaratat e paanësisë**, të cilën duhet ta nënshkruajnë anëtarët e KPP, në fillim të procedurës së konkurrimit, për të deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.

Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, KPP ka listuar kandidatët fitues me mbi 70 pikë (mbi 70% të pikëve) dhe lista e fituesve është shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, si dhe në faqen e internetit të institucionit.

Në rastet kur kandidatë të caktuar kanë marrë më pak se 70 pikë, njësia përgjegjëse, pas mbarimit të afatit 5 ditor të ankimit nga kandidatët për rezultatin e vlerësimit (*pika 22, Kreu IV, e VKM nr.243, datë 18.3.2015*), ka listuar kandidatët fitues për fazën pasardhëse (*në rastet kur ka patur më shumë se 1 kandidat fitues*), e më tej, në përfundim të procedurës ka bërë shpalljen e fituesit dhe procesi ka vijuar me daljen e aktit të emërimit.

Konstatim: Nga sa analizuam më sipër, vlerësohet se nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara nga ligji për të realizuar procese të administrimit të shërbimit civil, janë kryer procedurat e rekrutimit, nëpërmjet konkurrimit të hapur për pozicionet e kategorisë ekzekutive, të kryhen sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe **nuk ka asnjë rast** të emërimit në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

Në të gjitha rastet e shpalljes së vendeve të lira, rezulton se janë zbatuar kërkesat e nenit 22, 23, 24 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe janë respektuar afatet e parashikuara në pikën 8 e 10, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, si dhe pika 9, Kreu II, e VKM nr. 242, datë 18.3.2015, ku përcaktohet se, shpallja e procedurës së pranimit bëhet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrencës; afati i dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele jo më pak se 10 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes; për pranim në shërbimin civil jo më pak se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.

Në disa raste, gjatë zhvillimit të këtyre procedurave janë evidentuar parregullsi jo të karakterit procedural, por material, që janë detyrim për tu plotësuar, të tilla si:

- Mungesa e deklaratës së paanësisë e nënshkruar nga anëtarët e KPP-së dhe
- Mungesa e deklaratës së pranimit apo mospranimit për të regjistruar intervistën me gojë.

Në këto kushte, është detyrë e njësisë së burimeve njerëzore që në proceset e reja të rekrutimit, të kujdeset për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore që hartohen në një procedurë konkurrencë dhe ti administrojë ato në dosjet përkatëse të secilës procedurë.

III.2/b. Procedura e lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive.

Plotësimi i pozicioneve të lira në kategorinë ekzekutive, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, evidentohet në 4 pozicionet e paraqitura më poshtë:

- “*Specialist auditit*”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm;
- “*Specialist për dokumentacionin zgjedhor*”, në Drejtorinë e Administratës Zgjedhore;
- “*Specialist për koordinimin*”, në Drejtorinë e Administratës Zgjedhore;
- “*Specialist për menaxhimin financiar*”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit

Në të katër procedurat ka patur nga 1 kandidat, nëpunës civilë të së njëjtës kategori (*kandidaturat kryenin detyra brenda institucionit*), që plotësonin kushtet për lëvizjen paralele, si dhe kërkesat e posaçme të vendit të punës, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013.

Të gjitha pozicionet janë shpallur në portalin Agjencia Kombëtare i Punësimit dhe Aftësive dhe në faqen e internetit të institucionit të bashkisë dhe në përmbajtjen e shpalljes për konkurrencë, janë të përfshira të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 4, të kreut VII, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, siç janë:

- a) pozicioni i punës që është vakant (*emërtesa e pozicionit sipas strukturës dhe organikës në fuqi*);

- b) përshkrimi i përgjithshëm i punës për atë pozicion;
- c) kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët;
- ç) dokumentet që duhet të dorëzohen nga kandidatët dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
- d) afati i dorëzimit që është i përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
- dh) data e daljes së rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kushteve minimale të procedurës së lëvizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifike të vendit të punës;
- e) fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë;
- f) mënyra e vlerësimit të kandidatëve;
- g) data e daljes së rezultateve të konkurrimit;
- gj) mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Procedura e lëvizjes paralele, sipas pikës 6, kreu VII, të VKM nr.243, datë 18.3.2015, përfshin dy faza:

- a) Verifikimin e kandidatëve, të cilët përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
- b) Vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë.

Nga këqyrja e materialeve rezulton se, në zbatim të pikave 7, 8, 9 e 10, të kreut VII, të aktit nënligjor, njësia përgjegjëse:

- Ka realizuar verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- Ka realizuar njoftimin e verifikimit paraprak (*lista me emrat e kandidatëve*), publikuar në AKPA dhe në faqen e internetit të institucionit.

➤ *Vlerësimi i kandidatëve nga Komisioni i Brendshëm.*

Në bazë të përcaktimeve të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pikave 12 - 18/1, të kreut VII, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga Komisioni i Brendshëm, i cili bazohet në strukturën e ndarjes së pikëve si më poshtë:

- a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë, për përvojën (*10 pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave; 15 pikë për tejkallim të kërkesave; 20 pikë për tejkallim domethënës të*

kërkesave), 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse (3 pikë për tejkalim të lehtë të kërkesave; 5 pikë për tejkalim të kërkesave; 10 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave), 10 pikë për çertifikimin/vlerësimet më të fundit pozitive (5 pikë për çertifikimin/vlerësimin “mirë”; 10 pikë për çertifikimin/vlerësimin në nivelin “shumë mirë”).

b) 60 pikë intervista me gojë.

Komisioni i Brendshëm, sipas akteve ligjore, ka në përbërje të tij 3 anëtarë:

- a) 1 përfaqësues nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, kur është e mundur, i të njëjtit nivel ose i një niveli më të lartë se pozicioni që rekrutohet;
- b) eprorin direkt;
- c) 1 përfaqësues të emëruar nga titullari i institucionit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, Komisioni i Brendshëm ka realizuar vlerësimin përfundimtar për dokumentacionin e dorëzuar dhe intervistën me gojë, duke vlerësuar kandidatët për secilën procedurë.

Në përfundim të secilës procedurë, është publikuar shpallja e fituesit, në portalin AKPA dhe në faqen zyrtare të bashkisë. Më pas njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e emërimit për secilin fitues si më poshtë:

- ✓ *****, me aktin nr. 114, datë 24.02.2022, është emëruar në pozicionin, “Specialist audit”;
- ✓ *****, me aktin nr. 3936, datë 18.04.2023, është emëruar në pozicionin, “Specialist për dokumentacionin zgjedhor”;
- ✓ *****, me aktin nr. 7643, datë 17.11.2023, është emëruar në pozicionin, “Specialist për koordinimin”;
- ✓ *****, me aktin nr. 2676/3, datë 08.01.2021, është emëruar në pozicionin, “Specialist për dokumentacionin zgjedhor”.

Çdo proces i kryer gjatë zhvillimit të procedurave si më sipër, është pasqyruar në “Procesverbalet” e mbajtura pranë institucionit të mbikëqyrur nga grupi i punës dhe të firmosura edhe nga nëpunësit përgjegjës të KQZ.

III/2.c Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikua përmbushja e kërkesave ligjore të periudhës së provës, të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të

ndryshuar; kreu VI, i Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar.

Për periudhën objekt mbikëqyrjeje, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë emëruar nëpunës civilë në periudhë prove **18** punonjës të cilët vijojnë punën në institucion, si më poshtë:

- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2187, datë 19.4.2022, në pozicionin “*Specialist finance*”, në Sektorin e Kontrollit Financiar.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 14825, datë 22.11.2019, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Materialeve Zgjedhore.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 5111, datë 11.5.2021, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Materialeve Zgjedhore.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2257, datë 10.12.2020, në pozicionin “*Specialist për llogaritje rakordim për taksat*”, në Sektorin për Denoncimet Ankimet dhe Sanksionet”.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2942, datë 20.7.2022, në pozicionin “*Specialist për administrimin e të dhënave*”, në Sektorin e Zhvillimeve Dixhitale.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 475, datë 20.01.2021, në pozicionin “*Specialist për votimin e emigrantëve*”, në Drejtorinë për Votimin nga Jashtë.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 01, datë 04.1.2023, në pozicionin “*Specialist për administrimin e të dhënave dixhitale*”, në Sektorin për Administrimin e të Dhënave Dixhitale.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 1867, datë 23.03.2022, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Administrimit dhe Zhvillimit të Votimit.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 6066, datë 13.07.2021, në pozicionin “*Specialist për subjektet zgjedhore*”, në Sektorin për Subjektet Zgjedhore dhe Dekriminalizimin.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 5335, datë 17.05.2021, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e mbikëqyrjes Financiare.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 1869, datë 23.03.2022, në pozicionin “*Specialist për hartimin e akteve*”, në Sektorin e Hartimit të Akteve.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2512, datë 23.05.2022, në pozicionin “*Specialist për hartimin e akteve*”, në Sektorin e Hartimit të Akteve.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 7041, datë 02.12.2021, në pozicionin “*Specialist për hartimin e akteve*”, në Sektorin e Hartimit të Akteve.
- ***** , emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 7182, datë 12.10.2023, në pozicionin “*Specialist për denoncimet dhe ankimet*”, në Sektorin për Denoncimet, Ankimet dhe Sanksionet.

- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 1154, datë 23.02.2022, në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit.
- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 3141, datë 13.09.2022, në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit.
- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 846, datë 03.02.2021, në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit.
- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 3150 datë 02.04.2021, në pozicionin “*Specialist i burimeve njerëzore*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore.

Rezultoni se, për të gjithë nëpunësit si më sipër, ka përfunduar periudha e provës, e cila, bazuar në përcaktimet e pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, zgjat një vit nga data e aktit të emërimit.

Konstatohet se, të gjithë nëpunësit kanë kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA dhe në përfundim të tij janë vlerësuar me pikë, ku kanë marrë mbi 50% të pikëve. Nëpunësit **janë vlerësuar** për rezultatet individuale në punë, për periudhën e provës, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore. Periudha e provës ka përfunduar me daljen e vendimit të konfirmimit si nëpunës civil për nëpunësit përkatës.

Nga verifikimi i mëtejshëm konstatohet se, në disa raste, për procedurën e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës, **mungon mendimi me shkrim i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë**, pasi **nuk është caktuar nga eproi direkt**. Ky është një akt i rëndësishëm që duhet të shoqërojë vendimmarrjen e eprorit direkt në fund të periudhës së provës, ç

(Për nëpunësit që kanë përfunduar periudhën e provës, të dhënat lidhur me: kryerjen e ciklit të trajnimit pranë ASPA-s; vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës; si dhe, akti i konfirmimit si nëpunës civil, janë pasqyruar në Tabelën nr.1, që i bashkëlidhet projektraportit si pjesë e tij).

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes rezultoni se, **10** punonjës janë ende në periudhë prove, bëhet fjalë për:

- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 4538, datë 03.05.2023, në pozicionin “*Specialist për Koordinimin*”, në Sektorin e Koordinimit dhe Informimit.
- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 4537, datë 03.05.2023, në pozicionin “*Specialist për Koordinimin*”, në Sektorin e Koordinimit dhe Informimit
- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2141/3, datë 04.04.2023, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm.

- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 3477, datë 05.04.2023, në pozicionin “*Specialist i administrimit të votimit*”, në Sektorin e Administrimit dhe Zhvillimit të Votimit.
- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 3478, datë 05.04.2023, në pozicionin “*Specialist i administrimit të votimit*”, në Sektorin e Administrimit dhe Zhvillimit të Votimit.
- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 3591, datë 10.04.2023, në pozicionin “*Specialist për denoncimet dhe ankimet*”, në Sektorin për Denoncimet, Ankimet dhe Sanksionet.
- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 7182, datë 12.10.2023, në pozicionin “*Specialist për denoncimet dhe ankimet*”, në Sektorin për Denoncimet, Ankimet dhe Sanksionet.
- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 3477, datë 05.04.2023, në pozicionin “*Specialist për koordinimin ndërkombëtar*”, në Sektorin e Vëzhgimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar.
- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2211, datë 29.03.2023, në pozicionin “*Specialist për koordinimin ndërkombëtar*”, në Sektorin e Vëzhgimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar.
- *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 7292 datë 24.10.2023, në pozicionin “*Specialist për arkivën*”, në Sektorin e Protokollit dhe Arkivës.

Konstatim: Nga sa analizuam më sipër, vlerësohet se, procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës nga eprori direkt, duke i konfirmuar nëpunës civilë punonjësit të cilët kanë përmbushur peirudhën e provës, është kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, ndërkohë që në disa raste mungon mendimi me shkrim i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë.

Sipas pikës 2, neni 24, i ligjit, si dhe kreut VI “*Periudha e provës*”, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, caktimi i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë për të udhëzuar nëpunësin në periudhë prove, është një element i domosdoshëm, për orientimin e nëpunësit të ri në kryerjen e detyrës dhe që duhet të përfshihet në aktin e emërimit. Në përfundim, procedura e konfirmimit apo jo të nëpunësit civil, duhet të jetë e plotësuar me të gjithë elementët, përfshirë këtu edhe mendimin me shkrim të nëpunësit më të vjetër civil në detyrë.

Kjo mangësi, është një parregullsi e eprorit direkt të nëpunësit në periudhe prove, i cili sipas pikës 4, kreu VI, të VKM-së, nuk ka caktuar nëpunësin më të vjetër në kujdestari, por që nuk e cënon në thelb procesin e konfirmimit, si dhe marrëdhënien e punës të nëpunësve civilë të konfirmuar. Ajo vihet në dukje në këtë moment, për t’u patur parasysh në vijim, që raste të tilla të mos përsëriten dhe procedura e konfirmimit apo jo të nëpunësit civil, të jetë e plotësuar me të gjithë elementët, sipas kërkesave të ligjit.

IV. Aspektet procedurale të procedurës së konkurrimit për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese.

Rregullat procedurale të konkurrimit për të plotësuar pozicionet e punës në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues (*lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë*), janë të parashikuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”.

Sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari, nga nëpunësit civil të së njëjtës kategori, nëpërmjet *procedurës së lëvizjes paralele*, e nëse me anën e kësaj procedure pozicionet e lira nuk plotësohen, atëherë vijon procedura për plotësimin e vendeve të lira me *procedurën e ngritjes në detyrë*.

- Nga analiza e të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, Janar 2019 - Dhjetor 2023, nga njësia përgjegjëse e institucionit të KQZ, janë zhvilluar dhe kanë përfunduar me fitues **19** procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, nga këto, për **12** raste, procedura ka përfunduar me ngritje në detyrë, nga punonjës pjesë e shërbimit civil brenda institucionit ose nga jashtë institucionit. Bëhet fjalë për punonjësit e emëruar në këto pozicione pune:

1. ***** , emëruar në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Administratës Zgjedhore*”;
2. ***** , emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Logjistikës dhe Dixhitalizimit*”;
3. ***** , emëruar në pozicionin “*Shef Sektori i Materialeve Zgjedhore*” në Drejtorinë e Logjistikës dhe Dixhitalizimit;
4. ***** , emëruar në pozicionin “*Shef Sektori për Administrimin e të Dhënave Dixhitale*” në Drejtorinë e Logjistikës dhe Dixhitalizimit;
5. ***** , emëruar në pozicionin “*Drejtor për Votimin nga Jashtë*”;
6. ***** , emëruar në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin për Subjektet Zgjedhore dhe Dekriminalizimin*”, Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit;
7. ***** , emëruar në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Mbikëqyrjes Financiare*”, Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit.
8. ***** , emëruar në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin për Denoncimet dhe Sanksionet*”, Drejtoria e Ligjshmërisë;
9. ***** , emëruar në pozicionin “*Drejtor për Komunikimin dhe Koordinimin*”;
10. ***** , emëruar në pozicionin “*Shef në Sektorin e Edukimit dhe Informacionit*”, Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit;
11. ***** , emëruar në pozicionin “*Drejtor i Menaxhimit dhe Buxhetit*”;

12. *****, emëruar në pozicionin “Shef në Sektorin e Burimeve Njerëzore”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Nga këqyrja e materialeve rezulton se, në të gjitha rastet e ngritjes në detyrë, nga kandidatë të brendshëm, kandidatët që kanë aplikuar për këtë procedurë, i plotësojnë kushtet minimale dhe kërkesat e veçanta sipas shpalljes për konkurrim, të përcaktuara në pikën 2, të kreut III, të aktit nënligjor, të cilat janë:

- ✓ Janë nëpunës civilë të konfirmuar, me kategori page sipas përcaktimit në shpallje, e vërtetuar në të gjitha rastet me aktet përkatëse të konfirmimit të statusit;
- ✓ Nuk kanë masë disiplinore në fuqi;
- ✓ Janë administruar vlerësimet e punës për periudhën e fundit, sipas formatit të vlerësimit, të nënshkruar nga nëpunësit pjesëmarrës në vlerësim.
- ✓ Gjithashtu, bazuar në planin vjetor të pranimit si dhe nevojat që kanë lindur gjatë vitit kalendarik, njësia përgjegjëse ka shpallur procedurat e konkurrimit për çdo pozicion, duke bërë të njohur edhe planin e zhvillimit të procedurës. Shpallja e procedurës së konkurrimit për secilin pozicion është publikuar në portalin “AKPA” dhe në faqen e internetit të institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në pikat 3 - 7, të kreut II, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar.

Në vijim, mbështetur në pikën 4 dhe 6, të kreut III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, konstatohet se, është respektuar në të gjitha rastet afati prej 35 ditësh kalendarike për shpalljen e procedurës së konkurrimit me ngritje në detyrë, si dhe afati prej 15 ditësh kalendarike për dorëzimin e dokumentacionit nga kandidatët e interesuar për këtë procedurë.

- ✓ Konkurrimi për procedurën e ngritjes në detyrë, sipas pikës 21, të kreut III, përfshin dy faza:
 - a) Verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
 - b) vlerësimin e kandidatëve.

Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, **ka kryer verifikimin paraprak** të aplikantëve, nëse ata i plotësojnë ose jo kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpallje. Procedurat e verifikimit të kandidatëve janë kryer jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, afat ky i parashikuar në pikën 22, të kreut III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015.

Për çdo procedurë të realizuar, lista paraprake me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës është shpallur në portalin “AKPA” dhe në faqen e internetit të institucionit. Për këtë procedurë kanë aplikuar nëpunës të një kategorie paraardhëse të punësuar në administratën e KQZ (nëpunës nga brenda institucionit të mbikëqyrur).

✓ *Vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND)*

Për të realizuar fazën e dytë të konkurrimit, që është faza e vlerësimit të kandidatëve, mbështetur në parashikimet e pikës 6, të nenit 26, të ligjit për nëpunësin civil, njësia përgjegjëse ka ngritur Komitetin e Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND).

KPND është ngritur me 5 (pesë) anëtarë, është kryesuar nga njësia përgjegjëse dhe në përbërje ka patur një anëtar të zgjedhur nga titullari, midis nëpunësve civilë të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të institucionit, eprorin direkt të vendit të punës për të cilin është organizuar konkurrimi dhe dy ekspertë të fushës. Në caktimin e anëtarëve të këtij organi kolegjal janë mbajtur parasysh parashikimet e pikës 7, të kreut III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar dhe në të gjitha rastet KPND i ka marrë vendimet në praninë e të gjithë anëtarëve të tij.

Në testimin me shkrim dhe me gojë të kandidatëve, KPND ka realizuar vlerësimin e kandidatëve:

- a) Jetëshkrimin, vlerësimi maksimal 20 pikë. (*Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e arsimit, përvojës e trajnimeve, të lidhura me fushën si dhe vlerësimin e arritjeve individuale në punë*).
- b) testimin me shkrim, vlerësimi maksimal 40 pikë;
- c) Intervistën e strukturuar me gojë, vlerësimi maksimal 40 pikë.

Për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPND kanë përgatitur testet përkatëse. Në të gjitha rastet është hartuar çelësi i përgjigjeve, i cili është nënshkruar nga anëtarët e KPND.

Testet përmbajnë pyetje me alternativa dhe me shtjellim. Pyetjet me alternativa janë hartuar sipas rregullave të përcaktuara në pikën 1, të ndarjes V/5, të udhëzimit të DAP, si dhe brenda fushës së njohurive dhe aftësive, kompetencave, mbi të cilat do të zhvillohet testimi, të përfshira në shpalljen për konkurrim. Anëtarët e KPND kanë korrigjuar testet dhe kanë vlerësuar kandidatët duke dhënë pikët për secilin.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se, në vlerësimin me shkrim, anëtarët e KPND, kanë zbatuar rregullat e pikës 8, të paragrafit III/6, të udhëzimit të DAP, duke pjestuar shumën totale të pikëve me pesë (*në bazë të numrit të vlerësuesve*).

Në përfundim të këtij testimi, si dhe të vlerësimit të jetëshkrimit (i cili është bërë sipas modelit të vlerësimit në Aneksin nr.7, bashkëlidhur udhëzimit të DAP), kanë radhitur kandidaturat (*në rastet kur ka patur më shumë se një*), të cilët janë kualifikuar për fazën e intervistës me gojë.

Në lidhje me intervistën me gojë, KPND, ka ndjekur këto hapa:

- Ka hartuar pyetjet që lidhen me njohuritë, aftësitë, eksperiencën që nevojiten për pozicionin e punës dhe që janë brenda fushës së testimit të publikuara në shpallje, të cilat janë të njëjta për të gjithë kandidatët.
- Brenda afateve të parashikuara, KPND ka zhvilluar intervistën me gojë me secilin nga kandidatët dhe më pas ka hartuar raportin e procedurës së zhvilluar duke bërë vlerësimin, i cili, sipas udhëzimit të DAP, është i njëjtë me atë të lëvizjes paralele, por shuma totale, në këtë rast, pjesëtohet me pesë (numri i vlerësuesve).
- Në të gjitha rastet, kandidatët kanë nënshkruar deklaratat e mospranimit për të regjistruar intervistën me gojë.
- Rezulton që anëtarët e KPND, nuk kanë nënshkruar deklaratën e paanësisë, për të konfirmuar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.

Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, KPND ka hartuar raportin përfundimtar për rezultatin e konkurrimit.

Njësia e burimeve njerëzore, ka respektuar afatet që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore dhe ka shpallur fituesit në portalin “AKPA”; në faqen zyrtare të institucionit dhe njëkohësisht ka nxjerrë aktin e emërimit.

- Ndërkohë, nëpërmjet **lëvizjes paralele** kanë përfunduar **4** procedura ku janë emëruar punonjësit në këto pozicione:
 1. ******, emëruar me aktin nr. 6568, datë 27.09.2021, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Trajnimeve dhe Dokumentacionit Zgjedhor*”, Drejtoria e Administratës Zgjedhore;
 2. ******, emëruar me aktin nr. 847, datë 03.02.2021, në pozicionin “*Shef i Sektorit të Materialeve Zgjedhore*”, Drejtoria e Logjistikës dhe Dixhitalizimit;
 3. ******, emëruar me aktin nr. 1876/1, datë 11.11.2020, në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale*”;
 4. ******, emëruar me aktin nr. 7660, datë 20.11.2023, në pozicionin “*Shef i Sektorit të hartimit të Akteve*”, Drejtoria e Ligjshmërisë.
- Rezulton se **3** procedura kanë përfunduar me konkurrim me *kandidatë nga jashtë shërbimit civil* (brenda shifrës prej 20% të vendosur si kufizim me ligjor) dhe bëhet fjalë për kandidatët fitues të emëruar në pozicionet:
 1. ******, emëruar me aktin nr. 2983, datë 26.07.2022, në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Logjistikës dhe Dixhitalizimit*”;
 2. ******, emëruar me aktin nr. 1989, datë 31.08.2022, në pozicionin “*Shef në Sektorin e Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimin*”, në Drejtorinë e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes dhe Monitorimit;

3. *****, emëruar me aktin nr. 1758, datë 17.03.2023, në pozicionin “Shef në Sektorin e Materialeve Zgjedhore”, në Drejtorinë e Logjistikës dhe Dixhitalizimit.

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në pikën 4, të nenit 26, parashikon se, procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese mund të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë, nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, për këto pozicione, nga njësia përgjegjëse e institucionit, janë përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në

Konstatim: Komisioneri konstaton se procedurat e konkurrimit, të zhvilluara nëpërmjet lëvizjes paralele/ngritjes në detyrë/pranim nga jashtë shërbimit civil, për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, janë zhvilluar në zbatim të rregullave të parashikuara në nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil, kreun III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, si dhe kreun V, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

- V. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32 të ligjit për nëpunësin civil nga ana e titullarit të institucionit; respektimi i kërkesave ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse për organizimin e konkurrimit dhe respektimi i procedurave të konkurrimit nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, gjatë realizimit të procesit.**

Procedurat e konkurrimit për pranimin në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues në institucionet e pavarura, organizohen në bazë të rregullave të parashikuara në nenin 32, të ligjit për nëpunësin civil dhe kreun III, VIII dhe IX, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar.

Struktura dhe organika në fuqi e institucionit të KQZ ka 3 (tre) pozicione të kategorisë së lartë drejtuese, konkretisht pozicionet

- “Sekretar i Përgjithshëm”, kategoria e pagës **I-2**;
- “Drejtor i Përgjithshëm i Administrimit të Zgjedhjeve”, kategoria e pagës **I-4**;
- “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse”, kategoria e pagës **I-4**.

Pozicioni “Sekretar i Përgjithshëm”, është plotësuar me aktin nr. 60 prot., datë 15.3.2017, periudhë përpara objektit të mbikëqyrjes në institucion, e cila është mbikëqyrur më parë nga Komisioneri, duke e trajtuar edhe këtë rast. Të dhënat mbi këtë emërim, ashtu si dhe për emërimet e tjera në shërbimin civil, janë të pasqyruara në tabelat shoqëruese të këtij projektraporti.

- ✓ Rezulton se, pozicioni “Drejtor i Përgjithshëm i Administrimit të Zgjedhjeve”, është plotësuar me procedurën e pranimit në kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, me konkurrimit të hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, të parashikuar nga shkronja “b”, pika 1, kreu VIII, të VKM nr. 118, datë. 5.3.2014, i ndryshuar.

Procedura e konkurrimit është paraprirë nga një vendim i titullarit (në këtë rast i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve), që kjo procedurë të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil.

Për plotësimin e këtij pozicioni, nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, është publikuar shpallja e procedurës së konkurrimit në portalin “Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të institucionit.

Në shpalljen e publikuar për pozicionin në fjalë, është përcaktuar se, procedura është e hapur për nëpunësit civilë të konfirmuar në kategorinë e mesme drejtuese të shërbimit civil dhe nëse nuk paraqiten kandidatë të tillë, procedura do të vijojë me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në këtë kategori.

Nga verifikimi i mëtejshëm rezulton se, në përmbajtjen e shpalljeve për konkurrimit, janë përfshirë të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 6, të kreut VIII, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014, i ndryshuar. Gjithashtu, konstatohet se, është respektuar afati kohor prej 60 ditësh që parashikon pika 4, e kreut VIII, të aktit nënligjor.

Në vijim, duke qenë se nuk është ofruar asnjë kandidat i përshtatshëm nga sistemi i shërbimit civil, që të plotësojë kërkesat e përgjithshme e të posaçme për këtë pozicion pune, konstatohet se ky pozicion, është plotësuar me procedurën e pranimit në kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, nëpërmjet konkurrimit të hapur edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori.

➤ *Faza e parë e konkurrimit*

Nga verifikimi rezulton se, në përmbajtjen e shpalljes për konkurrim, janë përfshirë të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 4-6, të Kreut VIII, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014, i ndryshuar, procedura është shpallur në datën 07.12.2020, në portalin Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe në faqen zyrtare të institucionit, në zbatim të parimit të transparencës së procesit dhe barazisë së kandidatëve, si dhe në përputhje të përcaktimit lidhur me afatin kohor prej 60 ditësh përpara datës së konkurrimit (datë 05.02.2021).

Në përfundim të verifikimit paraprak është kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit, kandidatja e vetme *****, duke e shpallur këtë fakt edhe në portalin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, si dhe në faqen zyrtare të institucionit.

Më tej, njësia e burimeve njerëzore, ka publikuar verifikimin përfundimtar në portalin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe në faqen zyrtare të institucionit, duke njoftuar datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet konkurrimi.

➤ *Faza e dytë e konkurrimit*

Pasi është përfunduar faza e parë e konkurrimit, është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP) për vlerësimin e kandidatit nëse plotësonte kushtet e pranimit në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, për pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm i Administrimit të Zgjedhjeve*”.

KPP-ja ka organizuar testimin me shkrim dhe me gojë të kandidatit dhe ka realizuar vlerësimin e tij sipas përcaktimeve:

- a) Vlerësimi i jetëshkrimit (CV), vlerësimi maksimal 10 pikë (*Vlerësimi i jetëshkrimit përfshin vlerësimin e arsimit, eksperiencës dhe trajnimeve, të lidhura me fushën si dhe vlerësimin e arritjeve vjetore*).
- b) Testimi me shkrim, vlerësimi maksimal 40 pikë;
- c) Intervistë e strukturuar me gojë, vlerësimi maksimal 50 pikë.

Për realizimin e vlerësimit të kandidatit, komisioni i pranimit ka hartuar pyetjet e vlerësimit me shkrim dhe pyetjet e vlerësimit me gojë. Pyetjet janë hartuar duke patur në konsideratë fushën e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Secili nga anëtarët e KPP ka vlerësuar çdo pyetje me pikë. Intervista me gojë është zhvilluar menjëherë pas përfundimit të korrigjimit të testimit me shkrim.

Në përfundim të vlerësimit, sipas raportit përfundimtar të KPP, datë **08.2.2021**, është shpallur kandidatja *****, e cila ka grumbulluar 79.2 pikë. Të gjitha materialet i janë dorëzuar njësisë së burimeve njerëzore, e cila në fund të procedurës, ka nxjerrë aktin e emërimit:

- *****, me aktin nr. 984 prot., datë 06.02.2021, të Burimeve Njerëzore, emërohet në pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm i Administrimit të Zgjedhjeve*”, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Konstatim: Procedura e konkurrimit për pranimit nga jashtë shërbimit civil, në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, në institucionet e vetëqeverisjes vendore, për pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm i Administrimit të Zgjedhjeve*”, është organizuar në bazë të rregullave të parashikuara në nenin 32, të ligjit për nëpunësin civil, si dhe kreun III, VIII dhe IX, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014 “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*”, i ndryshuar.

- ✓ Përsa i takon pozicionit “*Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse*”, konstatohet se është plotësuar me procedurën e caktimit të anëtarit të TND-së në një pozicion të rregullt, të parashikuar në nenin 30, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 118, datë. 5.3.2014 “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*”, i ndryshuar.

Konstatohet se, kjo procedurë është iniciuar nga një kërkesë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, drejtuar DAP, për vënie në dispozicion të listës së anëtarëve të TND-së, e mbështetur në pikën 5, të nenit 30, të ligjit për nëpunësin civil.

Në vijim të procedurës, pas përzgjedhjes së anëtarit të TND-së nga lista e pritjes dhe miratimit prej tij të pozicionit të paraqitur, Departamenti i Administratës Publike ka miratuar emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse*”, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kategoria e pagës II-a.

Në fund të procedurës për plotësimin e pozicionit si më sipër, me aktin nr. 1889/3, datë 16.3.2021, njësia e burimeve njerëzore të institucionit të KQZ, ka bërë emërimin e anëtarit të TND-së, në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse*”.

Konstatim: Procedura e emërimit në pozicionin e nivelit të lartë drejtues, “*Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse*”, është organizuar në përputhje të rregullave të parashikuara në nenin 30 “*Caktimi i anëtarit të TND-së në një pozicion të rregullt*”, të ligjit “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe kreun VII, të VKM nr. 118, datë

5.3.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar.

VI. Vlerësimi i rezultateve në punë, si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (Zyrtari raportues, Zyrtari kundërfirmues, Zyrtar autorizues).

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u verifikua procedura e ndjekur nga institucioni për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë për 6 mujorin e dytë të vitit 2023, në përputhje me kërkesat e nenit 62, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Gjatë procesit të verifikimit në institucionin e mbikëqyrur, u konstatua se, formularët e vlerësimit të punës janë hartuar, sipas formatit të miratuar në Lidhjen nr. 2, të e VKM nr. 109, datë 26.2.2014, e ndryshuar, ku janë materializuar të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (ndarja A); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (ndarja B); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (ndarja C); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, kërkesën për këshillim, aftësinë menaxheriale për nëpunësit në pozicionet e nivelit të ulët e të mesëm drejtues (ndarja Ç); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmblodhur i arritjes së objektive kryesore të punës nga nëpunësit.

Në zbatim të programit të kontrollit, për të gjithë nëpunësit që, në momentin e mbikëqyrjes, punonin në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, u verifikuan vlerësimet e rezultateve në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2023.

Duke patur parasysh katër nivelet e vlerësimit “shumë mirë”, “mirë”, “kënaqshëm” dhe “jokënaqshëm”, nga verifikimet e kryera, vlerësimi përfundimtar i nëpunësve, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 1: Niveli i vlerësimit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023

Periudha e vlerësimit	Korrik – Djetor 2023			
Niveli i vlerësimit përfundimtar	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm

Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	49	7	-	-
Totali	56			

Rezultoni që nga 75 pozicione pune pjesë e shërbimit civil, 8 pozicione pune janë të lira dhe 9 nëpunës vazhdojnë periudhën e provës.

Nga të dhënat e vlerësimit të nëpunësve civilë si më sipër, rezultoni se:

- 49 nëpunës janë vlerësuar në nivelin 1 “shumë mirë”;
- 7 nëpunës janë vlerësuar në nivelin 2 “mirë”;

Nivelet e ulëta të vlerësimit 3 “kënaqshëm” dhe 4 “jokënaqshëm”, **nuk janë përdorur** në asnjë rast.

Mënyra se si është vepruar në këtë rast, të krijon përshtypjen se, procesi i vlerësimit, cedon në drejtim të objektivitetit dhe njëkohësisht, krijon mundësinë e humbjes së interesit dhe motivimit të nëpunësve për të kryer punën me një nivel gjithnjë e më të lartë cilësie, në kushtet kur vlerësimin “shumë mirë” e marrin, pothuajse të gjithë nëpunësit civilë të institucionit.

Në vlerësimin e nëpunësit civil duhet përdorur i gjithë spektri i vlerësimit, me qëllim që të pasqyrojë realitetin e performancës së çdo nëpunësi civil dhe të rrisë frymën e konkureshmërisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së punës.

Kjo situatë vlerësimi, skemë e cila është pothuajse e pamundur që të përputhet me realitetin, nuk e nxit nëpunësin drejt rritjes së nivelit të tij profesional dhe përpjekjes për të përmirësuar njohuritë e tij.

Nga këqyrja e formularit të vlerësimit, vërehet se ai është i plotë nga pikëpamja formale, pasi është nënshkruar nga të gjithë personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji për kryerjen e procedurës së vlerësimit (*zyrtari raportues dhe zyrtari kundërfirmues/autorizues*).

Por, duke analizuar përmbajtjen e tij, konstatohet se pavarësisht se është kryer vlerësimi me pikë, për çdo objektiv të përcaktuar për periudhën e vlerësimit (Korrik – Dhjetor 2023), **mungojnë komentet** në të gjitha rubrikat.

Vlerësimi i nëpunësit civil, sipas formatit të miratuar në vendimin nr. 109, datë 06.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, krahas vlerësimit me pikë, përmban detyrimin e plotësimit të komenteve përkatëse në lidhje me vlerësimin në rubrikat e veçanta dhe atë përfundimtar, arsyet e këtij vlerësimi si dhe rekomandimet dhe vërejtjet e nevojshme.

Mungesa e komenteve në rastin konkret, do të thotë se jemi përpara një procesi administrativ me mangësi në raport me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, i cili shoqërohet me konkluzione me karakter subjektiv dhe të pa verifikueshme, si nga ana e zyrtarëve që marrin pjesë në proces pasi nuk mund të vlerësojnë konkluzionet e zyrtarit paraardhës, ashtu edhe nga ana e organeve mbikëqyrëse.

Për realizimin e një vlerësimi sa me objektiv, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014 “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, të ndryshuar, është përcaktuar dhe procedura që duhet të respektohet për procesin e vlerësimit të rezultateve në punë kompetencat për vlerësimin, si dhe fazat e vlerësimit.

Në kuptim të pikës 12, Kreu II, të vendimit të sipërcituar, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, i cili konsiston në tri faza:

Planifikimi;

Bisedimet e ndërmjetme; si dhe

Vlerësimi përfundimtar.

Zyrtarët që marrin pjesë në procesin e vlerësimit, në përditshmëri e kanë për detyrë të respektojnë zbatimin e këtyre fazave dhe dokumentimin e tyre, duke mbajtur shënime lidhur me momentet kur mbarëvajtja në punë duhet të përmirësohet dhe rrugët që duhet të ndiqen, më tej, këto shënime të materializohen në procesverbale të cilat duhet të ruhen së bashku me aktin e vlerësimit pasi përbëjnë praktikën që materializon procedurën e ndjekur.

Nga analiza e formularëve të vlerësimit, nuk konstatohen raste të mosmarrëveshjeve ndërmjet Zyrtarit raportues dhe/ose Zyrtarëve kundërfirmues dhe autorizues, lidhur me nivelet e vlerësimit, për shkak të pretendimeve të nëpunësit lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë.

Konstatim: Nga analiza e të gjitha rrethanave të parashtruara më sipër, rezulton se, institucioni i mbikëqyrur, nga pikpamja formale i ka kryer procedurat e vlerësimit të rezultateve në punë, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, i ndryshuar.

Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së vlerësimit, apo në përfundim të periudhës së provës, është miratuar nga nëpunësit e ngarkuar me kompetencën e vlerësimit, duke plotësuar në këtë mënyrë një nga elementet formalë të kërkuar nga formulari i vlerësimit.

Megjithatë, fakti që pjesa më e madhe e nëpunësve janë vlerësuar në nivelin 1 “*shumë mirë*”, që është niveli më i lartë i vlerësimit, si dhe mungesa e komenteve në rubrikat e vlerësimit, cedon objektivitetin e procesit, në drejtim të përmbajtjes së tij. Në këto rrethana, vëmë në dukje që zyrtarët vlerësues: *Zyrtartari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues dhe Zyrtari Autorizues*, si dhe

njësia e burimeve njerëzore, e cila mbikëqyr procesin e vlerësimit, duhet të respektojë të gjitha kërkesat e legjislacionit që rregullon këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil.

Për sa më sipër, zyrtarët që marrin pjesë në procesin e vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues/autorizues*), për të shmangur vlerësimet subjektive duhet të zbatojnë hap pas hapi të gjitha kërkesat që përcakton Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.109, datë 26.02.2014 “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, të ndryshuar, duke respektuar të gjitha fazat e vlerësimit dhe të kujdesen për dokumentimin e tyre në mënyrë shkresore, si nëpërmjet akteve të veçanta, apo të evidentimit të tyre në përmbajtjen e formularit të vlerësimit të punës, ç’ka do të kontrollohet në mbikëqyrjen pasardhëse që do të zhvillohet në këtë institucion.

VII. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u verifikuan procedurat administrative disiplinore të realizuara nga institucioni përgjatë periudhës objekt mbikëqyrje.

Shkelja e detyrimeve që e ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin civil, llojet e shkeljeve dhe masave disiplinore, organi kompetent disiplinor dhe procedurat që duhet të ndiqen në një procedim disiplinor janë të përcaktuara në kreun X “*Disiplina në shërbimin civil*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, nenet nga 57 - 61; në vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, i ndryshuar si dhe udhëzimin nr. 1, datë 2.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike “*Për elementët kryesorë proceduralë dhe material të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”.

Konstatohet se, për periudhën objekt mbikëqyrje, është realizuar **një procedurë disiplinore për “shkelje të lehta”**. Bëhet fjalë për nëpunësen ***** me detyrë “*Specialist në Sektorin e Vëzhgimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar*”, ndaj të cilës është zbatuar masa disiplinore “*Vërejtje*”, e parashikuar nga shkronja “a”, e nenit 58, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar. Masa disiplinore është marrë me aktin nr. prot., 3948, datë 7.11.2022, të eprorit direkt, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, duke respektuar procedurën ligjore dhe të drejtën e nëpunësit civil për tu thirrur, për t`u dëgjuar dhe për t`u mbrojtur.

Njësia e burimeve njerëzore, informoi grupin e punës se nëpunësja ***** nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente. Në këto kushte, masa disiplinore është ende në fuqi.

VIII. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.

Nga verifikimi i dokumentacionit që ka të bëjë me institutin e lirimimit nga shërbimi civil, u konstatua se, në subjektin e mbikëqyrur, në **6 raste**, ka përfunduar marrëdhënia e punës në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes.

Dorëheqja, si një nga mënyrat e lirimimit nga shërbimi civil, është e përcaktuar në nenin 64, pika 1 dhe nenin 66, pika 1, gërma “*dh*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Në rastin konkret, janë liruar nga shërbimi civil, si pasojë e dorëheqjes, nëpunësit si më poshtë:

- ***** , nëpunës civil në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve të IT, ka paraqitur kërkesë me shkrim për dorëheqje nga detyra. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit me aktin nr. 2855, dt. 4.7.2022, **ka deklaruar** lirimimin nga shërbimi civil të nëpunësit.
- ***** , nëpunës civil në pozicionin “*Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, ka paraqitur kërkesë me shkrim për dorëheqje nga detyra. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit me aktin nr. 84, dt. 9.1.2023, **ka deklaruar** lirimimin nga shërbimi civil të nëpunësit.
- ***** , nëpunës civil në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Përgatitjes së Akteve*”, në Drejtorinë Juridike dhe Dokumentacionit Zgjedhor, ka paraqitur kërkesë me shkrim për dorëheqje nga detyra. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit me aktin nr. 185, datë 16.1.2023, **ka deklaruar** lirimimin nga shërbimi civil të nëpunësit.
- ***** , nëpunës civil në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Zhvillimeve Dixhitale*”, në Drejtorinë e Logjistikës dhe Dixhitalizimit, ka paraqitur kërkesë me shkrim për dorëheqje nga detyra. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit me aktin nr. 6072/2, dt. 27.6.2023, **ka deklaruar** lirimimin nga shërbimi civil të nëpunësit.
- ***** , nëpunës civil në pozicionin “*Shef i Sektorit të Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve IT*”, ka paraqitur kërkesë me shkrim për dorëheqje nga detyra. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit me aktin nr. 3695, datë 22.11.2022, **ka deklaruar** lirimimin nga shërbimi civil të nëpunësit.
- ***** , nëpunës civil në pozicionin “*Drejtor i Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve*”, në Drejtorinë e Logjistikës dhe Dixhitalizimit, ka paraqitur kërkesë me shkrim për dorëheqje nga detyra. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit me aktin nr. 2529, datë 31.05.2022, **ka deklaruar** vendimin për lirimimin nga shërbimi civil të nëpunësit

Në të gjitha rastet, aktet e lirimimit nga shërbimi civil, **janë deklaruar** nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit, sipas përcaktimeve të shkronjës “*dh*”, pika 1, dhe shkronjës “*a*”, pika 4, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar. Në këto raste, ka dalë edhe akti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare nga titullari i institucionit.

Vërejmë se, për nëpunësit e larguar si pasojë e dorëheqjes, ligji nr. 152/2013, në nenin 64, pika 4, parashikon se, “*Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil*”, ç’ka duhet të mbahet parasysh nga njësia përgjegjëse.

IX. Dosja e personelit

Gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucion në lidhje me zbatimin e kërkesave të ligjit për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, u konstatua se, dokumentacioni i verifikuar, në këtë rast, administrohet edhe në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil.

Të dhënat, të cilat kanë të bëjnë me përvojën në punë, fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*), diplomën e arsimit të lartë që kërkon pozicioni i punës (*nivelin e diplomës dhe fushën e studimeve univeristare*), si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, janë paraqitur në Tabelën nr.1 dhe 2, bashkëlidhur projektraportit.

Nga këto të dhëna rezulton se, në institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në momentin e mbikëqyrjes janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil 67 nëpunës, moshë mesatare e nëpunësve është 46 vjeç, ku, 43 punonjës janë femra dhe 24 punonjës janë meshkuj.

Përsa i përket arsimit, konstatohet se, 53 nëpunës kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore publike; 9 nëpunës kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore private; 5 nëpunës e kanë kryer arsimin e lartë në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit. Diplomat e tyre janë të njehsuara nga Ministria e Arsimit, që është institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave.

Konkluzion: Sa më sipër, vlerësohet se, dosjet e personelit janë të rregullta, të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore.

X. Regjistri Qendror i Personelit (RQP) dhe platforma e bashkëpunimit “administrata.al”.

Regjistri Qendror i Personelit (RQP) është një bazë unike të dhënash shtetërore, ku ruhet e përpunohet elektronikisht informacioni për institucionin dhe burimet njerëzore aktive për institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore. Institucionet si më sipër, kanë detyrimin që të hedhin, të përditësojnë dhe të raportojnë periodikisht

në RQP, të dhënat që lidhen me institucionin, të dhënat që lidhen me të punësuarit, si dhe të përdorin modulet pjesë përbërëse të sistemit.

Institucioni i mbikëqyrur ushtron të drejtat dhe detyrimet që ka për RQP-në dhe platformën e bashkëpunimit "administrata.al", nëpërmjet nëpunësit të burimeve njerëzore.

Për të verifikuar veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, lidhur me hedhjen dhe përditësimin e të dhënave në Regjistrin Qendror të Personelit dhe platformën e bashkëpunimit "administrata.al", grupi i punës përzgjedhi disa raste të regjistrimit të nëpunësve dhe, në prezencë të Përgjegjësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore, u verifikuan të dhënat e hedhura.

Gjatë verifikimit u konstatua se, sistemi HRMIS (*Regjistri Qendror i Personelit*), përmban një grup të dhënash që plotësohen dhe përditësohen nga njësia përgjegjëse DAP dhe një grup të dhënash që plotësohen dhe përditësohen nga institucioni.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar dhe pikën 1, kreu I e pikën 4, kreu II, të lidhjes 3, të vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave "*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit*", është konfirmuar si përdorues i RQP – së, *****. Konkretisht, u konstatua se institucioni plotëson dhe përditëson të dhënat si më poshtë:

- Akti i emërimit në pozicionin ku është i emëruar nëpunësi (*numër protokolli dhe datë*);
- Plotësimi i të dhënave për çdo të punësuar, sipas rubrikave të përcaktuara në sistem ku përfshihen të dhënat individuale lidhur me identifikimin e nëpunësit, edukimi, kualifikimet, gjuhët e huaja, masat disiplinore nëse ka, përvoja e punës (*sipas librezës së punës apo të dhënave të gjeneruara nga sistemi e-albania*), historiku i marrëdhënies së punës ndër vite të cilin e gjeneron sistemi (*akti i emërimit për herë të parë në institucion, ndryshimi i pozicionit të punës për shkak të ristrukturimit të institucionit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë apo transferimit të përkohshëm*), vlerësimi i rezultateve në punë i cili realizohet në mënyrë periodike çdo 6 muaj të vitit kalendarik, përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil e për këtë shkak edhe përfundimi i marrëdhënies financiare me institucionin. Në të gjitha këto raste në sistem, hidhet numri dhe data e aktit me të cilin është kryer veprimi administrativ përkatës.

Rezultoi se, për nëpunësit civil që u përzgjedhën për verifikim, njësia e burimeve njerëzore i ka hedhur dhe përditësuar të gjitha të dhënat që kërkohen në çdo rubrikë të sistemit. Në të gjitha rastet, aktet e përfshira në mënyrë elektronike në RQP, janë të njëjta me aktet e administruara fizikisht në dosjet individuale të krijuara për nëpunësit e verifikuar më sipër.

*

* *

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil gjatë procesit të mbikëqyrjes në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, për periudhën Janar 2019 - Dhjetor 2023.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat si më poshtë:

- Tabela nr.1: “Nëpunës të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”;
- Tabela nr.2: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil”;
- Procesverbalet e konstatimit të mbajtura gjatë procesit të verifikimit në institucionin e mbikëqyrur.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha